



BASHKIA VLORE – DREJTORIA E URBANISTIKËS

RINDËRTIMI I MUREVE RRETHUES,
PËRGJATË PROJEKTIT PËR
RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËVE
"MYSLYM GJOLEKA", "AHMET
LEPENICA", "HYSNI MUKA" NË
LAGJEN "KUSHTRIM", VLORE.

RAPORTI TEKNI

RAPORTI TEKNIK

VEND NDODHJA

Objekti i ndërhyrjes ndodhet në lagjen “Kushtrimi”, në qytetin e Vlorës, përgjatë segmentit rrugor të parashikuar në projektin urban të sistemimit të zonës. Ndërhyrja konsiston në prishjen dhe rindërtimin e mureve rrethues ekzistues përgjatë kufijve të pronave private, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës urbane dhe harmonizimit të elementëve ndërtimorë me sistemimin e ri rrugor dhe të trotuareve.

Zona karakterizohet nga zhvillim urban ekzistues me objekte banimi dhe shërbimi, ku muret aktuale paraqiten të amortizuara dhe jo të unifikuara nga ana arkitektonike dhe konstruktive. Projekti parashikon përshtatjen e mureve të rinj me konfiguracionin urban të rrugës, trotuareve, ndriçimit dhe elementëve të tjerë të infrastrukturës publike.



GJENDJA EKZISTUESE



INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN E PROPOZUAR

Në kuadër të ndërhyrjeve për përmirësimin urban dhe sistemimin e infrastrukturës publike në lagjen “Kushtrimi”, Bashkia Vlorë parashikon realizimin e punimeve për prishjen e mureve ekzistuese të amortizuara dhe rindërtimin e mureve të rinj rrethues, në përputhje me projektin teknik dhe konfiguracionin urban të zonës. Projekti bazohet në detajet teknike dhe planimetrinë e miratuar të murit rrethues.

Objekti: RINDËRTIMI I MUREVE RRETHUES, PËRGJATË PROJEKTIT PËR RIKONSTRUKSIONIT E RRUGËVE "MYSLYM GJOLEKA", "AHMET LEPENICA", "HYSNI MUKA" NË LAGJEN "KUSHTRIM", VLORË.

Vendndodhja: Bashkia Vlore


Nga verifikimet në terren rezulton se një pjesë e mureve ekzistuese paraqiten të dëmtuara, të amortizuara nga koha dhe faktorët atmosferikë, si dhe jo të unifikuara nga ana estetike dhe konstruktive. Në disa segmente evidentohet degradim i suvasë, plasaritje dhe mungesë stabiliteti konstruktiv. Bazuar në projektin e miratuar *RIKONSTRUKSION I RRUGËS “MYSLYM GJOLEKA”, “AHMET LEPENICA” DHE “HYSNI MUKA”, VLORË.*, është konstatuar se gjurma e rrugës së re kalon pjesërisht mbi muret ekzistuese rrethuese të pronave private, për shkak se rruga ekzistuese ka qenë me gjerësi të pamjaftueshme dhe nuk plotëson standardet e nevojshme të qarkullimit dhe sigurisë rrugore. Për këtë arsye, zgjerimi i gjurmës së rrugës është konsideruar domosdoshmëri infrastrukture dhe urbanistike.

Gjithashtu, konfiguracioni aktual i mureve nuk përputhet me standardet urbane dhe me nevojat funksionale të aksesit në pronat private, duke sjellë nevojën për ndërhyrje të kontrolluar dhe rindërtim sipas projektit të ri.

Për realizimin e këtij projekti është zhvilluar procesi i shpronësimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) përkatës për shpronësimet, duke krijuar bazën ligjore për ndërhyrjen në terren dhe realizimin e zgjerimit të rrugës.

Në kuadër të këtij investimi, është parë e arsyeshme që të realizohet rindërtimi i mureve rrethuese për asetet e prekura nga zgjerimi i rrugës, si dhe ndërtimi i unifikuar i të gjitha mureve përgjatë aksit rrugor, me qëllim:


- përmirësimin urban dhe estetik të zonës;
- krijimin e një konfigurimi të unifikuar arkitektonik përgjatë rrugës;
- rritjen e sigurisë dhe funksionalitetit të pronave kufitare;
- përshtatjen me kuotat dhe konfigurimin e ri të infrastrukturës rrugore.




Muret e reja do të realizohen me strukturë betoni dhe kangjella metalike sipas detajeve të projektit. Ngjyra e kangjellave metalike do të jetë e zezë, në përputhje me zgjidhjen arkitektonike të propozuar.

Gjatë hartimit të projektit janë marrë në konsideratë kushtet ekzistuese në terren, hyrjet aktuale të objekteve dhe nevoja për akses në pronat private, duke ruajtur funksionalitetin dhe komunikimin me parcelat përkatëse.


PRERJA "A-A"



PRERJA "B-B"



PAMJE DHE KONFIGURACIONI I MURIT RRETHUES



Gjithashtu:

- Lihet detyrë gjatë zbatimit të projektit, sipas rastit specifik, ku do të lihen hapësirat për hyrje në oborret e rrethuara.
- Lihet detyrë gjatë zbatimit që prishjet e mureve ekzistuese të bëhen duke zbatuar kushtet teknike të domosdoshme, pa sjellë dëmtime në pjesën tjetër të murit.

- Lihet detyrë gjatë zbatimit, të verifikohen dhe azhurnohen kuotat topografike dhe të përshtaten me gjendjen faktike në terren.

Projekti synon përmirësimin e standardeve të infrastrukturës rrugore dhe të imazhit urban të zonës, duke garantuar një zgjidhje funksionale, estetike dhe të integruar me zhvillimin urban të lagjes “Kushtrimi”, Vlorë.

Konc. Ark. Orges Deraç

Konfirmoi. Ing. Edmond Beqiri

Miratoi. Dr. Ingli Xhaferaj